



Gjirokastra, Albania

KONKURS NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIM URBAN

THIRRJE E HAPUR PËR PROJEKT PROPOZIME

Faza I: 10 Nëntor 2015

PROJEKTIMI I BYPASS-IT TË QYTETIT TË MBROJTUR NGA UNESCO, GJIROKASTRËS

TEMAT E REFERENCËS

Promovues

Atelier Albania, me kërkesë të Ministrisë së Kulturës dhe mandatuar nga Zyra e Kryeministrit, shpall një konkurs ndërkombëtar për të mbledhur projekt propozime për projektimin urban të Bypass-it të qytetit të mbrojtur nga UNESCO, Gjirokastrës. Përfshirja e by-passit në territorin e qytetit do të ndikojë drejtpërdrejtë trafikun në qendrën historike, e cila është projektuar e ngritur për të qenë një zonë e lirë nga makinat dhe kryesisht këmbësore.

Manifesto

Qyteti i Gjirokastrës shquhet si një qytet unikal për nga kompozimi urbanistik dhe arkitektonik. Qëllimi kryesor i këtij konkursi është përfitimi i projekt-ideve të krijimit të një Bypass-i, i cili zgjidh problemin e trafikut në Pazarin e Gjirokastrës, duke e shndërruar atë në një zonë për këmbësorët, pa cënuar autenticitetin dhe karakterin e zonës së ndërhyrjes. Ky projekt kërkon të përmirësojë qarkullimin e automjeteve dhe rikthimin e qendrës historike në identitet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur Atelier Albania synon të ftojë ekipe shumë-disiplinëshe të përbërë nga arkitektë, urbanistë e planifikues, inxhinierë të rrugëve, e ekspertë të transportit dhe trashëgimisë, të cilët do të gjenerojnë propozime origjinale projektimi për të zgjidhur problemet e mobilitetit në qytet, por duke vlerësuar kontekstin historik dhe kulturor të vendit.

Nëpërmjet këtij konkursi, i cili nuk është i fokusuar thjesht në një pyetje inxhinierike, kërkohet një zgjidhje e integruar. Megjithatë objekti kryesor i projekt propozimeve do të jetë bypass-i, pyetja e konkursit është shumë më tepër sesa një pyetje për zgjidhje inxhinierike. Pyetja e projektimit sjell së bashku projektues, inxhinierë, konsulentë të transportit dhe trashëgimisë, të cilët do të propozojnë një qasje të integruar kundrejt pikëpyetjes për bypass-in e Gjirokastrës.

Përfituesit

Ky konkurs, nëpërmjet dizenjimit të Bypass-it, synon rikthkimin e zonës së pazarit në një zonë të aksesueshme për të gjithë këmbësorët, duke e përforcuar edhe më shumë karakterin dhe identitetin e tij. Krijimi i kesaj unazeje të re të lëvizjes, duhet të jetë e mirë-integruar me sistemin rrugor të tërë qytetit, sikurse duhet të sigurojë mbrojtjen, konservimin e vlerave historike-kulturore dhe atyre peisazhistike të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Gjirokastrës. Bypass-i, pasi të ndërtohet do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe vizitorëve të shumtë, që e vizitojnë atë, sikurse edhe do të ndihmojë që qendra historike e qytetit të mbetet e pashqetësuar nga lëvizja e trafikut të makinave.

Autoriteti Kontraktues



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është Autoriteti Kontraktor për këtë process, me kërkesë të Ministrisë së Kulturës.

Zona e Konkursit

Gjirokastra, e ashtëquajtur ndryshe dhe “Qyteti i Gurtë” është shpallur zonë e mbrojtur nga UNESCO në vitin 2005. Zanafilla e qytetit, kalaja, e cila daton rreth gjysmës së parë të shekullit të XIV, përbën qendrën kompozicionale të tij. Pjesa tjetër e qytetit shtrihet në një terren të thyer, duke i dhënë qytetit një karakter dinamik. Larmishmëria e relievit ka bërë që nga ana kompozicionale lagjet të qëndrojnë si njësi të vecuara.

Pazari i qytetit deri në shekullin e XVII përbënte qendrën ekonomike të tij. Në vitet më vonë, ai u zhvendos në vendin ku ndodhet sot, duke krijuar një qendër të dytë, e cila e pasuar nga humbja e funksioneve administrative të kalasë, u bë qendra e vërtetë e qytetit. Në qendrën e tij bashkohen të gjitha rrugët që e lidhin atë me lagjet e banuara, duke i dhënë qytetit një skemë organizimi radiale.

Zona e cila është subjekt i hartimit të projekt-ideve, paraqitet në hartën e vendodhjes së konkursit dhe përfshin Qendrën Historike dhe Zonën e Mbrojtur të Qytetit të Gjirokastrës.



Qëllimi i Konkursit / Pyetja e Konkursit

Konkursi do të ndërtohet dhe do t'u përgjigjet këtyre çështjeve kryesore:

- Cila është trajektorja që do të ndjekë Bypass-i, e cila ka impaktin më të ulët në zonën e ndërhyrjes?
- Si të integrosh Bypass-in me sistemin rrugor të qytetit/ rrjetin e lagjeve, Qendrën Historike dhe vetë qytetin?
- Si të projektosh Bypass-in e qytetit në përputhje me rregulloren për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur?
- Si të projektosh një rrugë përtej principeve të mirëfillta inxhinierike dhe ta kthesh atë në një rast të 'projektimit më të mirë'?

Objekti

Produkti i konkursit do të jetë Projektimi i "Bypass-it të qytetit të Gjirokastrës", i cili mendohet të jetë përreth Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur. Projektimi i tij ka për qëllim kthimin e zonës së Pazarit, në një zonë këmbësore, të aksesueshme nga i gjithë komuniteti dhe vizitorët. Ky konkurs synon të përmirësojë trafikun dhe qarkullimin e automjeteve në Qendrën Historike, sikurse kërkon të rikthejë sërish zonën e Pazarit në një qendër ekonomike, tërheqëse për biznesin e aktivitete të tjera.

Ekipet pjesëmarrëse pritët të sjellin projekt propozime krijuese, zgjidhje të integruara dhe inovative, që përshtaten dhe ruajnë identitetin historik e kulturor të zonës, ndërkohë që lehtësojnë lëvizjen brenda dhe jashtë saj.

Konkursi organizohet në dy faza. Faza e parë bazohet në shprehjen e interesit dhe përfundon me një listë të shkurtër të skuadrave më të mira.

Konkurentët që do të vijojnë në fazën e dytë, për të dhënë propozimet e tyre të projektimit, do t'u kërkohej të punojnë për të arritur si më poshtë:

- Të studiojnë strukturën dhe morfologjinë urbane të qytetit të Gjirokastrës;
- Të studiojnë zonën e konkursit dhe rrethinat e tij në aspektin hapësinor, topografik, kontekstual dhe nivelin e ndërhyrjes që lejohet;
- Të analizojnë sistemin rrugor duke marrë në konsideratë terrenin, gjerësinë dhe konfiguracionin e rrugëve, dendësinë e monumenteve, popullësinë, aktivitetet dhe përbërjen gjeologjike;
- Të analizojnë kontekstin dhe të propozojnë trajektoren e Bypass-it që shkakton impaktin më të ulët, duke mos cënuar aspak në prishjen e peisazhit, monumenteve të kulturës, zonat arkeologjike, sikurse dhe zonat e gjelbërta dhe publike;
- Të studiojnë në mënyrë posaçme si Bypass-i lidhet me kontekstin, duke siguruar që është në harmoni të plotë me të;
- Të parashikojnë zona të mundshme parkimi dhe qëndrimi: zgjidhje 'park & ride';
- Të ruajnë dhe konservojnë zonën në përputhje me rregulloren për mbrojtjen, konservimin dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur bazuar në VKM Nr. 619, datë 7.7.2015;
- Të mirë-integrohet Bypass-i me sistemin rrugor ekzistues, duke e çliruar zonën e pazarit nga lëvizja automobilistike;
- Propozimi i një plani menaxhimi të sistemit rrugor në afërsi të Qendrës Historike duke

përcaktuar intervalin, madhësinë e mjetit, mundësi alternative kalimi;

- Propozim i një projekt-ideje për shtrimin dhe gjerësinë e Bypass-it të qytetit të Gjirokastrës;
- Parashikim të kostove të propozimit;
- Propozimi i një plan veprimi;
- Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovativ.

Metodologjia

Atelier Albania është një njësi e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e mandatuar për identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe pasurimin e arkitekturës e planifikimit nëpërmjet të menduarit përtej kornizave. Në këtë kontekst ne stimulojmë dhe mbështesim pjesëmarrjen e grupeve me profesionistë ndërkombëtarë që do të punojnë së bashku me profesionistë vendas. Ne besojmë se ky bashkëpunim me bazë ekipi do të pasurojë mënyrën sesi informohet projekti me të gjitha njohuritë e nevojshme locale dhe ekspertizën e nivelit të lartë të projektimit. Për më tepër, ne duam të eksperimentojmë një proces konkursi bashkë-krijues, ku projektuesit dhe disa aktorë lokalë janë përfshirë në një proces përzgjedhës.

Rezultatet e pritshme

FAZA I:

Në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, metodologjinë dhe vizionin ndaj subjektit të konkursit. Çdo dorëzim do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe ekipet do të përzgjidhen bazuar në kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit të përmendura në Fazën 1.

Mes ekipeve të kualifikuara Juria do të short-listojë ekipet që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së Fazës 1. Këto ekipe do të thirren për të punuar gjatë një faze të dytë, për një Koncept që do të synojë plotësimin e objektivit të konkursit dhe pyetjeve të konkursit, mbi bazën e një informacioni dhe një detyrë projektimi të detajuar.

FAZA 2:

Në fazën e “Projekt-Idesë”, çdo propozim do të analizohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe bazuar në kriteret e vlerësimit të Fazës 2, do të përzgjidhet një propozim fitues.

Bashkimi i skuadrave vendase me të huajat

Çdo ekip ndërkombëtar stimulohet nga organizatorët për t'u lidhur me partneritet me një ekip vendas dhe çdo ekip lokal për t'u lidhur gjithashtu me një partner ndërkombëtar. Atelier Albania beson se një bashkëpunim i tillë mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë zbatimin e projektit. Megjithatë, në thirrjen për fazën e parë, nuk është kusht përzgjedhje që ekipet të kenë një partner lokal apo ndërkombëtar. Ne besojmë se ky bashkëpunim mund të rrisë impaktin e propozimit dhe të përmirësojë cilësinë e zbatimit. Gjatë aplikimit për fazën e parë nuk është kusht përzgjedhës që ekipet të kenë një partner vendas apo ndërkombëtar; megjithatë, të kesh një partner në këtë fazë është positive dhe mund të ndihmojë për krijimin e një vizioni më koherent dhe të kontekstualizuar, i cili sigurisht mund të rrisë shancet e ekipeve për përzgjedhje.

Përshtatshmëria

Konkursi është i hapur për të gjithë profesionistët arkitektë, arkitektë pejsazhi dhe urbanistë, të cilët arrijnë të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të jenë të regjistruar apo të njohur nga një organ zyrtar akreditimi në vendin e origjinës së aplikantit; ose
2. Atje ku njohja apo regjistrimi nuk aplikohet me ligj, aplikanti të jetë anëtar i një institucioni profesional, në vendin e origjinës.

Të gjithë aplikantët duhet të japin dëshmi të vlefshmërisë së regjistrimit profesional, njohjes apo anëtarësimit, në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Secili prej ekipeve të Fazës 1 duhet të ketë në përbërje:

- Arkitekt/ arkitekt pejsazhi/ urbanist – UDHËHEQËS SKUADRE
- Inxhinier për Projektues Rrugësh – konsulent
- Inxhinier transporti – konsulent
- Ekspert trashëgimie – konsulent

Të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të identifikohen në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST, e cila mund të shkarkohet në adresën www.app.gov.al

Dokumente Aplikimi

Konkurentët duhet të dorëzojnë një seri me dokumente, në mënyrë që të jenë në përshtatje me kërkesat e konkurimit për fazën e parë dhe të dytë të konkursit. Dokumentet janë të karakterit ligjor-informativ. Detajimet në lidhje me dokumentet që duhen dorëzuar jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit (DST). Ndërkohë më poshtë jepet vetëm një listë e shkurtër e tyre.

Dokumentet e Fazës 1:

- Deklarata e Përbërjes së Skuadrës,
- CV të Stafit Primar,
- Metodologjia,
- Deklarata e Vizionit
- Të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme sipas përcaktimeve standarte të Agjencisë së Prokurimit Publik (shtojca 6 e DST)

Dokumentet e Fazës 2:

- Ide Projektimi sipas Termave të Referencës dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Kriteret e Kualifikimit

Juria do t'i zgjedhë aplikantët që do të vlerësohen gjatë fazës së parë bazuar mbi këto kriteret fillestare kualifikimi:

- Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara në Fazën 1
- Përbërja profesionale e skuadrës (arkitekt/arkitekt pejsazhi/urbanist, inxhinierë projektim rrugësh, konsulent transporti dhe trashëgimie)
- Eksperiencat e ngjashme të studios dhe stafit kyç
- Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
- Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e problematikave të përcaktuara në konkurs

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë aplikimet e Fazës 2 bazuar në kriteret e mëposhtme:

- *Krijimtaria*
- *Përshtatshmëria e propozimit me funksionin e kërkuar*
- *Faktori i lartë i zbatueshmërisë së idesë së projektimit*
- *Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin*
- *Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)*

Produkti Final

Konkursi do të përfundojë me zgjedhjen e një ekipi. Ekipi fitues duhet të jetë një ekip i mirë-pajisur, i cili do të jetë në gjendje të angazhohet në procesin pas-konkurs.

Ekipi fitues do të angazhohet në fazën vijuese, e cila konsiston në përgatitjen e studimit të fizibilitetit bazuar në propozimin fitues.

Procesi Post-Konkurs

Për të koordinuar më mirë punën mes skuadrës fituese dhe porositësit të projektit, organizatorët parashikojnë 1 takim mes skuadrës, klientit dhe grupeve të interesit, gjatë procesit të detajimit të projekt-idesë. Koncepti këtu është që aktorët të vijnë së bashku për të ndarë idetë, propozimet dhe sugjerimet e tyre, nën kujdesin e anëtarëve të Jurisë dhe institucioneve të specializuara. Ky takim do të realizohet në Gjirokastër.

Çmimet e Konkursit

Fituesi i konkursit do të vlerësohet me një çmim në vlerë monetare 30,000 Euro.

Skuadra fituese do të nisë negociatat me klientin për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, bazuar në propozimin fitues.

Platforma e Konkursit

Lloji I Konkursit:	Konkurs Projektimi Urban me Short-Listim
Faza 1:	Thirrje e Hapur për Shprehje Interesi
Kërkesat e Fazës 1:	Sipas Shtojcës 6 të Dokumentit Standart të Tenderit
Avantazh:	Bashkimi i studiove vendase dhe ndërkombëtare të Arkitekturës
Vlerësimi i Jurisë:	Lista e skuadrave të kualifikuara – ‘Lista e Shkurtër’
Faza 2:	Projekt-idea
Kërkesat e Fazës 2:	Dorëzimi i materialeve ilustruese të Projekt-Idesë
Fazë e ndërmjetme:	Vizitë në terren dhe workshop me ‘aktorët’ vendas
Vlerësimi i Jurisë:	Propozimi më i mirë që plotëson kriteret e konkursit
Çmimet:	Çmimi për fituesin 30,000 Euro dhe Lidhja e Kontratës së studimit të fizibilitetit

Kalendari i Konkursit 2015

Thirrje e hapur për shprehje interesi:	27 Tetor
Afati Faza 1:	10 Nëntor , ora 10.00
Lista e Shkurtër:	12 Nëntor
Ftesë për Projekt-Ide:	19 Nëntor
Përgatitja e Projekt-Idesë:	12 Nëntor - 10 Dhjetor
Workshop në Gjirokastrë:	27 Nëntor
Detyra finale e Projektimit + Plani i hapave:	19 Nëntor
Afati Faza 2:	10 Dhjetor, ora 18.00
Prezantimet Publike:	18-21 Dhjetor
Vlerësimi i Jurisë:	21 Dhjetor
Shpallja e Fituesve:	21 Dhjetor

Pas-Konkurs 2016

Negociatat e Kontratës	Janar-Shkurt 2016
Firmosja e Kontratës për Studimin e Fizibilitetit:	Shkurt 2016
Dorëzimi i Studimit të Fizibilitetit:	2016

INFORMACIONE PROKURIMI

Faza e shortlistimit do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në ndërfaqen me adresë: www.app.gov.al.

Dokumentet e tenderit mund të përftohen elektronikisht në po këtë ndërfaqe: www.app.gov.al.

Konkurentët e huaj, në mënyrë që të përdorin sistemin elektronik të prokurimit, duhet të regjistrohen on-line si një operator ekonomik në ndërfaqen: <https://www.app.gov.al/ep/Registration.aspx>.

Instruksione të mëtejshme për konkurentët ndërkombëtarë mund të merren nga manuali i përdoruesit "EPS user manual – Economic Operators", i cili mund të shkarkohet nga ndërfaqja www.app.gov.al.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Secili prej Termave të Referencës mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Organizatorit të Konkursit:
<http://www.planifikimi.gov.al>

Apo, në faqet e dedikuara për këto Konkurse:
<http://competitions.planifikimi.gov.al/bypassroad/>

Mund të na kontaktoni edhe në:
atelieralbaniacompetitions@planifikimi.gov.al

Sqarimet lidhur me procedurën e prokurimit do të kërkohen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.



AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nr. 57
Kutia Postare 1023, Tiranë/ Shqipëri

www.planifikimi.gov.al
info@planifikimi.gov.al